



Rishikimi i Tretë i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE3) 2009

**Komentet e KOSTT sh.a. në Raportin Konsultativ të
ZRRë-së**

13.03.2009

Komentet e KOSTT sh.a. ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së

Ky dokument paraqet qëndrimet e KOSTT sh.a. ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE, të publikuar më datë 3 mars 2009 dhe Shtesës në këtë raport të datës 5 mars 2009

KOSTT sh.a. ka pranuar këtë raport, dhe mirëpret mundësin për t'u përgjigjur ndaj këtij raporti. Përgjigjet e KOSTT janë të përqendruara në arsyetime të mëtutjeshme lidhur me kërkesat e paraqitura në aplikacionin final dhe propozimet e ZRrE-së në këtë Raport.

1. KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Krahasimi KOSTT/KEK

Pa u ndalur në elementet përmbajtësore të dokumenteve (Raporti Konsultativ i ZRrE-së 3 dhe 5 Mars 2009), në disa pika vërehet një qasje komparative në mes kompanive KEK dhe KOSTT, dhe kjo konsiderohet që lë hapsirë për keqkuptime. Duke tentuar që të jemi sa më korrekt dhe të drejtpërdrejtë konsiderojmë se bizneset e këtyre dy kompanive megjithatë dallojnë dhe prezantimi narrativ përkrah njëra tjetrës i çështjeve që lidhen me tarifat e këtyre dy kompanive, lë përshtypje krahasimi dhe nganjëherë mundt të jep pasqyrë jo-reale. Trajtimi i tillë mund të krijoj konfuzione dhe paragjykime rreth performancës së mirë apo jo të mirë të njërës apo kompanisë tjetër, prandaj theksojmë nevojën e evitimit të këtij lloj prezantimi.

Termi TUoS

Konsiderojmë se ekziston një dis-harmoni në përdorimin e termit apo akronimit TUoS (Transmission Use of System) në Raportin Konsultativ (në gjuhë angleze). Akronimi TUoS sipas Metodologjisë Tarifore nënkupton të gjitha detyrimet që vendosen nga KOSTT për shërbimet që ofron, ku hyjnë: (1) detyrimi për shfrytëzim të rrejtë, (2) detyrimi për operim të sistemit dhe (3) detyrimi për operim të tregut. Sipas raportit konsultativ TUoS nënkupton vetëm detyrimin për shfrytëzim të rrejtë me të cilin ngarkohet furnizuesi, çka është jokonistente me Metodologjinë Tarifore dhe vet përdorimin e këtij termi.

Komente teknike

Në tabelën në fund të Raportin Konsultativ (në gjuhën angleze), detyrimi për operim të sistemit (SO) në kolonën e tarifës së 2008, i cili në fakt është detyrim me të cilin ngarkohen gjeneratorët e kyçur në rrjetin e distribucionit, krahasohet me detyrimin për operim të sistemit për 2009 për gjeneratorët e kyçur në rrjetin e transmisionit, çka pasqyrohet si një rritje tejet e madhe. Në kolonën “2008 Tariff” duhet vendosur detyrimin për operim të sistemit për gjeneratorët në transmision, i cili është komparativ me detyrimin për operim të sistemit në kolonën “2009 Proposed”.

2. HUMBJET NË TRANSMISION

Vlerave të paraqitura për humbjet në transmision në aplikacionin final të KOSTT për SHTE3, i është dhënë edhe arsytimi në shtojcën përkatëse. KOSTT ka shqyrtuar propozimin e dhënë në Raportin Konsultativ dhe mendon se vlera e propozuar është nën vlerën e cila del si rezultat i një analize shtesë që KOSTT e ka paraqitur në dokumnetin e bashkangjitur lidhur me arsyeshmërinë e humbjeve në transmision gjatë vitit 2009. Në raportin konsultativ nuk përmendet se a janë marrë në shqyrtim humbjet shtesë si pasojë e një regjimi specifik të furnizimit gjatë vitit 2009, regjim i furnizimit i cili reflektohet nga shkyçjet e shumta gjatë implementimit të projekteve investive. KOSTT nuk dëshironë që të përsëritet si në rastin e vitit 2008, që humbjet të rriten si pasojë e ngarkesave shtesë të shkaktuara nga një regjim i sforcuar i operimit të rrjetit të transmisionit e që paraqitet si përjashtim nga gjendja e operimit në kushte normale dhe këto të mbeten të pa rekonsiluara “ex-post”. Si pasojë KOSTT kërkon që në shpenzimet e lejuara për humbje në vitin 2009 të jenë:

$211 \text{ GWh} \times 31.3 \text{ €} = 6,604.3 \text{ €}$ apo 12 GWh më të mëdha se ato të propozuara në Raportin Konsultativ.

Për sqarimet të detajuara ju lutem i referoheni shtojcës së përgatitur nga KOSTT që bashkëngjitet kësaj kërkesë.(Shtojcë 1).

3. SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES

Për të sqaruar nënshpenzimet lidhur me mirëmbajtjen për vitin 2008, KOSTT dëshiron të bëjë të ditur se ka bërë përpjekje të shumta për të realizuar planet dhe gjithashtu ka bërë analizë lidhur me paraqitjen e shpenzimeve në aplikacion për tarifa. Analizat na tregojnë se ky proces i realizimit të buxheteve të mirëmbajtjes duhet shikuar nga perspektiva e tërë periudhës së Shqyrtimit të të Hyrave dhe nën-shpenzimeve të viteve të para të kompensohen në vitin e fundit. Kjo mund të shpjegohet me disa faktor ndikues si :

- Proceset e prokurimit që marrin kohë,
- Zotimi i buxheteve që varen nga procesi i miratimit të tarifës për çdo vit veç e veç,
- Risku i realizimit me kohë i të hyrave nga klientët,
- Fakti i mos eksperiencës së aplikimit të një regjimi të ri të sigurimit të të hyrave i shoqëruar me frikë që të mos hyjmë në obligime më të mëdha nga ato që mund të mbulohen

4. SHPENZIMET E PERSONELIT

Siç është theksuar edhe më lartë lidhur me krahasimet e bëra në mes të KEK dhe KOSTT, krahasimi i shpenzimeve të personelit lë përshtypjen se struktura kualifikuese si dhe pjesëmarrja e shpenzimeve të personelit në të hyrat totale është e njëjtë në KEK dhe KOSTT, gjë që nuk qëndron. Lidhur me këtë janë bërë krahasime preliminare dhe këto janë paraqitur edhe në aplikacionin final (kualifikimi superior në KOSTT ka pjesëmarrje me rreth 50 % deri sa në KEK me rreth 20 %). Vlenë gjithashtu të theksohet se kostoja e personelit në KOSTT 12-13% është e krahasueshme me kostot e kompanive simotra në region e më gjërë e që radhiten në 12-25% nga të hyrat e përgjithshme.

Sa i përket propozimit lidhur me numrin e personelit, që KOSTT të mbete në numrin e lejuar të personelit (230) për vitin 2008, do të theksojmë se KOSTT ka bërë marrëveshje me KEK për transferin e 11 (njëmbëdhjetë) operatorëve të NS Kosova A nga muaji Mars 2009 (pesë më shumë se në nënstacionet e rendit të njëjtë në KOSTT të cilët kanë qenë të punësuar në këtë NS), se është i domosdoshëm rekrutimi i 6 (gjashtë) operatorëve për NS Peja 3, se KOSTT është i obliguar të bëjë punësimin e një Auditori të Brendshëm (sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike), se duhet të mirret parasysh angazhimi i 6 (gjashtë) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve si dhe rekrutimi i stafit të ri të nevojshëm gjatë vitit 2009. Në qoftë se kjo i shtohet numrit virtual prej 210 punëtorëve të realizuar gjatë vitit 2008, atëherë kjo na reflekton me llogaritjen si në vazhdim:

$$210 + 11 + 6 + 1 + 6 = 234$$

Kufizimi i numrit të stafit, KOSTT-it i krijon pamundësi të rekrutimit të ekspertëve të rinjë të cilët do të duhej të trajnohen në mënyrë që KOSTT të jet në kapacitet t'i përmbushë objektivat e planifikuara në të ardhmen e afërt, të parapara në licencën e lëshuar nga ZRrE-ja..Prandaj kërkojmë që të rishikohet mundësia e një qasje më të balancuar për këtë çështje.

KOSTT vlerëson se kjo kërkesë nuk duhet t'i nënshtrohet kriterit të njëjtë si kërkesa e KEK-ut meqë kjo mund të jetë trajtuar nga aspekti i numrit më të madh të stafit në krahasim me standardet e kërkuara. Krahasimet që KOSTT ka bërë lidhur me numrin e personelit me kompanitë simotra me një eficiencë të dëshiruar, vlerësojmë se KOSTT ende është nën numrin e duhur të stafit që duhej të kishte.

5. KONKLUZIONE

Analiza Sensitive


Propozimin në Raportin Konsultativ për SHTE3 për korigjimin e disa pozicioneve të shpenzimeve e kemi vendosur në testim të sensitivitetit dhe kjo tregon një rritje të riskut me zvogëlimin e të hyrave nga ato të kërkuara me aplikacionin final.

Nga analizat sensitive të realizimit të të hyrave, vërehet se KOSTT ballafaqohet me një rrezik të pakontrollueshëm, sidomos duke pasur parasysh faktin se tarifa e propozuar e ZRrE-së mundëson realizimin e një shume të të hyrave e cila duke qenë se është në minimumin e nevojave të KOSTT për operim të sigurtë, është jo edhe aq relaksuese. Sipas analizave sensitive psh. në rast të mos furnizimit të kërkesës (mos realizimi të konsumit të planifikuar), dështimit të realizimit të prodhimit, apo të dyjave; KOSTT-i vihet përball një rreziku të mos-realizimit, i cili mund të reflektohet negativisht në biznesin e tij. Njëkohësisht ky rrezik nuk shpërblehet në mënyrë të duhur që t'i

përgjigjet psh. rritjes së komponenteve që do të mund t'i rrisnin të hyrat e KOSTT, kur dihen mundësitë e kufizuara prodhuese dhe importuese.

KOSTT mendon se ky është një rrezik real, i cili kërkon një menaxhim ex-ante, që nënkupton ngritjen e tarifës aktuale në mënyrë që të mundësohet një operim më i sigurtë dhe më relaksues. Cilido që të jetë veridikti përfundimtar kjo çështje duhet të jetë pjesë e vendimit që ZRRE-ja mund ta marrë.

Fig 1 Analiza Sensitive



Për sa i përket se si propozimi Juaj i paraqitur në Raportin Konsultativ për SHTE3 reflekton në rezultatet afatshkurta dhe asaj të rrjedhës së parasë me parashenjë negative (likuiditet negativë), parametra shumë domethënës për të prezantuar para institucioneve financiare që vlerësojnë aftësitë kredituese të kompanive, këtë mund ta vlerësoni me analizat që KOSTT ka bërë enkas për këtë proces të përcaktimit të tarifave të transmisionit.

Ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentin Shtojcë 2, që është marrë nga Modeli Financiar i KOSTT-it.

Përmbledhje e kërkesave

KOSTT konstaton se:

- KOSTT mund të pajtohet me nivelin e propozuar të humbjeve duke shtuar 12 GWh sipas arsyzhmërisë të dhënë në dokumentin e bashkangjitur lidhur me këtë;
- KOSTT do të pajtohet me numrin e stafit të ngritur për 4 punëtorë që do të caktonte numrin minimal prej 234 punëtorësh;
- KOSTT do të pajtohet që diskutimet lidhur me çështjen e shtruar nga KEK për ndarjen e kostove në mes të SHST dhe OS, të zhvillohen për periudhën e ardhëshme tarifore, meqenëse kjo detyrimisht jep të hyra më të ulëta se ato të propozuara, me konsekuenca në afarizmin e KOSTT-it.

(Fund i dokumentit)